



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova - Republicof Kosovo**  
**Komuna e Prishtinës**  
**Opština Priština -Municipality of Prishtina**



**EKSTRAKT I PROCESVERBALIT**

**të mbledhjes së jashtëzakonshme të Kuvendit, mbajtur më 23.03.2021, e cila filloj në orën  
11:00.**

Në mbledhje morën pjesë: Agim Kuleta, kryesues i Kuvendit, këshilltarët e Kuvendit: Vala Peshku, shefe e GP-së (PSD), Drilon Pireva (PSD), Genc Sherifi (PSD), Mimoza Sylejmani (PSD), Qëndrim Sahiti (PSD), Bashkim Beha (PSD), Nol Nushi (PSD), Adrian Berisha (PSD), Leonora Shabani - Bajraktari, shefe e GP-së (LVV), Vjosa Hamiti - Krasniqi (LVV), Arbër Vokrri (LVV), Mirsad Vitia (LVV), Besnik Mujeci (LVV), Egzon Azemi (LVV), Nazlie Bala (LVV), Halim Halimi, shef i GP-së (LDK), Milazim Vitija (LDK), Shefqet Osmani (LDK), Agim Gashi (LDK), Shefki Gashi (LDK), Hafiz Krasniqi (LDK), Haki Dragusha (LDK), Vlora Dumoshi (LDK), Jeta (LDK), Mustafë Krasniqi (LDK), Kushttrim Sopa (LDK), Kumrije Shabani - Rafuna - Hasani (LDK), Muhamet Selmani (PDK), Florida Canolli (PDK), Fadil Gashi, shef i GP-së Ramadani (PDK), Valbona Ajeti (AAK), Bukurie Canolli (AAK), Fikneta Bejtë (Grupi i pavarur), Vesel Makolli, shef i GP-së (AKR), Arbenita Murseli (AKR), Sami Boroci (AKR), Adelina Fazliji (AKR), Rifat Deri (i pavarur), Valbona Petrovci (e pavarur), Kreshnik Smajlaj (Grupi i pavarur).

**Munguan:** Migjen Shala (PDK), Sami Salihu (LDK), Elmire Nikçi - Rexha (LDK), Visare Gashi (PSD), Naime Osmani (LDK), Naim Hoxha (LVV), Leutrim Retkoceri (PDK), Suzan Kika, (PDK), Blerand Stavileci, shef i GP-së (PDK), Sokol Berisha (Grupi i pavarur) dhe Granit Shala (Nisma).

Të pranishëm ishin edhe: Shpend Ahmeti, Kryetar i Komunës, Selim Pacolli, nënkyrjetar i Komunës, Valbona Makolli, drejtoreshë e Drejtorisë së Financave, Fatime Hajdari, drejtoreshë e Drejtorisë së Parqeve, Genc Bashota, drejtor i Drejtorisë së Planifikimit Strategjik dhe Zhvillimit të Qëndrueshëm, Shkumbin Gashi, drejtor i Drejtorisë së Bujqësisë, Fatos Dibra, përfaqësues i Zyrës ligjore, Osman Bllaca përfaqësues i ekzekutivit dhe përfaqësues të Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal.

Mbledhjen e hapi dhe e kryesoit Agim Kuleta, kryesues i Kuvendit.

Kryesuesi konstatoi se më 37 vota për, u miratua ky

Rend i ditës:

1. Propozimvendimi për bartjen e buxhetit të paspenzuar nga viti 2020 në vitin 2021;
2. Propozimvendimi për autorizim të borxhit;
3. Propozimvendimi për dhënien në shfrytëzim të pronës së paluajtshme komunale, Bashkësisë islame të Kosovës.

Faqe 1 nga 5

**Pika e parë**  
**Propozimvendimi për bartjen e buxhetit të pashpenzuar nga viti 2020 në vitin 2021.**

Lidhur me Propozimvendimin për bartjen e buxhetit të pashpenzuar nga viti 2020 në vitin 2021, të pranishmit në pika të shkurtra i informoi Valbona Makolli, drejtoreshë, e cila tha se totali për bartje të mjeteve është 34 milionë e 347.176 euro, ku prej tyre janë dy kategori, kategoria e subvencioneve dhe kategorinë e investimeve kapitale. Kategoria e subvencioneve është 6 milionë 724 euro, ndërsa kategoria për investime kapitale janë obligimet e kompanive që janë lidhur kontratat me vonesë ose janë në procedurë të prokurimit.

**Agim Gashi** theksoi se nga Drejtoria e Financave u sqarua se për bartjen e mjeteve në shumën prej 34 milionë e 347 mijë e 176.33 euro, të cilat janë të shpërndara sipas planifikimit që ne e kemi miratuar buxhetin e vtit të kaluar, me përjashtime tek kodet buxhetore, p.sh. ndërtimi i rrugëve rurale, ndërtimi i rrugëve urbane, ku kompetencë e specifikimit, planifikimit të rrugëve të specifikuara ka qenë drejtoria. Ne duhet që ta shikojmë atë planifikim të drejtorisë se a i ka shpërndarë mirë apo nuk i ka shpërndarë mirë ato mjete në kuadër të atyre dy kodeve buxhetore, si në fushën e kulturës, arsimt apo fushave të tjera. Ka projekte që nuk mund të realizohen, prandaj jemi shumë të vetëdijshëm që këtë vit buxhetor aq janë mbrapa me procedura, se nuk ka me mundur me u realizuar, siç është p.sh. tuneli në rrugën "Agim Ramadani", pastaj edhe ndonjë projekt tjetër. Andaj, me një rishikim të ardhshëm të shkurtër të buxhetit ne do të mundemi t'i riplanetojmë ato mjete.

**Mirsad Vitia** tha se është për keqardhje kur thirret një seancë e jashtëzakonshme dhe ekzekutivi i Komunës së Prishtinës i jap aq pak rëndësi, duke mos qenë prezent as Kryetari i Komunës, as nënkyetari i parë, as ai i dyti!

Lidhur me këtë pikë, mund të konstatojmë se është një shumë e madhe e mjeteve e cila e përcjell këtë Komunë nga viti në vit, ku bëhet bartja e qindra, mijëra e miliona euro, dhe projektet e ndryshme të cilat barten nga viti në vit nuk realizohen. Ky mos realizim tregon për neglizhencë të Komunës së Prishtinës, të ekzekutivit komunal, tregon për në mos kompetencë të kryerjes së detyrave. Pra, është për keqardhje se si neve si Kuvendarë na vjen që të marrim një vendim të tillë. Edhe përkundër vërejtjeve që i kemi si Grup parlamentar, do ta votojmë këtë propozimvendim për bartje të mjeteve.

**Fiknete Bejta** falënderoi drejtoreshën për paraqitjen e raportit rrith bartjes së buxhetit, e cila tha se sa i përket specifikimeve për rrugë, është korrekte që të specifikohen ato projekte, pasi që ne nuk po kemi informata se cila është specifikisht dhe në cilin proces ka ndodhur. Andaj, në buxhetet e ardhshme projektet për buxhetet e ardhshme të specifikohen rrugë për rrugë se cilat janë, dhe t'i jepet prioritet aty ku ka banorë. Sa i përket bartjes së buxhetit, kjo po ndikohet edhe nga Ligji për prokurim publik, prandaj sa herë e kemi diskutuar për financat publike, kam kërkuar që të bëhet ndryshimi i Ligjit të procedurave publike, sepse ka shumë mangësi, ka afate të zgjatura për ankesa nga operatorët publikë, prandaj po ndodhin që procedurat e prokurimit të zgjaten dhe të kalojnë tek bartja e buxhetit.

**Sami Boroci** shprehu mendimin se sa i përket bartjes së buxhetit, që për këtë vit ose në këtë rast duhet me pasur për bazë që ka qenë një vit pandemik, ku kemi pasur një bllokim të projekteve kapitale, që detyrimisht ose rrjedhimisht kanë shtyrë që këto projekte me u vonuar ose me filluar procedurat më vonë.

Një shqetësim që mund ta ceku, është se kemi disa projekte që barten nga viti në vit dhe ende nuk janë realizuar.

Si grup e votojmë këtë bartje, duke shpresuar që edhe këto projekte gjatë këtij viti duhet të realizohen.

**Shefqet Osmani** bëri të ditur se kur e kanë votuar buxhetin për vitin 2021 kanë pasur disa kërkesa, që të futen disa projekte, si ai në fshatin Koliq, rruga në lagjen "Hajdaraj", ku kanë mbetur vetëm 800 metra rrugë e papërfunduar. Po ashtu nuk është futur në projekt fare rruga tjetër, nga fshati Koliq në fshatin Keqekollë, nga lagja "Tahiraj" deri tek lagja "Hasanaj", te Stacioni i Policisë, e cila rrugë lidhë dy komuna, Komunën e Podujevës dhe Komunën e Prishtinës. Kërkesë tjetër ka qenë edhe projekt për rrugën "Ibrahim Beka" në Ballaban, e cila kërkesë nuk është marrë parasysh nga ekzekutivi. Do të ishte mirë që këto kërkesa të merren parasysh dhe të hyjnë projekte për realizimin e tyre.

**Milazim Vitija** tha se sa i përket këtyre projekteve këtu që barten vit pas viti qysh prej mandatit të kaluar, rruga Vakovc - Flotacion, ka filluar dhe ende nuk ka përfunduar. Po ashtu kemi edhe shumë rrugë të tjera, si ajo nga lagja "Bullaj" - Krilevë, që është e projektuar, si dhe rruga Viti e Ulët - Viti e Epërme, projekte të cilat ende nuk kanë përfunduar, pra do të ishte mirë që të përfundojnë gjatë këtij viti.

**Muhamet Selmani** shprehu mendimin se bartjet kapitale janë të pashmangshme për të ndodhur, sidomos tek investimet kapitale. Sa i përket projekteve që po i diskutojmë tani, nuk e besoj se me këtë buxhet munden të futen projekte të reja, sepse ka dëshmuar edhe praktikat e kaluara që është e pa mundur të futen projekte të reja në buxhetet e bartura nga viti në vit, sepse kryesisht këto janë projekte të planifikuara dhe barten dhe zotohen në të ardhmen. Grupi parlamentar i PDK-së do ta përkrah bartjen e buxhetit për vitin 2021.

**Fadil Gashi** tha se sa i përket bartjes së buxhetit, AAK-ja e voton, mirëpo do të ishte mirë që të jetë prezent edhe drejtori i Drejtorisë së Investimeve Kapitale dhe Menaxhimit të Kontratave, pasi që po kemi disa kërkesa shtesë për rrugë të reja. Duhet të dihet saktë se nga po shkojnë mjetet financiare, ku disa rrugë janë nisur dhe kanë mbetur në gjysmë.

**Shefki Gashi** theksoi se nga viti në vit po mbisin mjete të pashpenzuara, andaj do të ishte e arsyeshme që të paktën dhjetë projekte me mbetur në gjysmë, mos me përfunduar, por me mbetur 200-300 projekte pa u realizuar, konsideroi se është plotësisht e paarsyeshme. Të thirret një mbledhje kaq e shpejtë, e jashtëzakonshme dhe mos të jenë prezent kryetari dhe drejtorët e drejtorive përkatëse, plotësisht është e pajustifikueshme.

**Egzon Azemi** fillimisht bëri vërejtje rreth seancës së kaluar, me ç'rast tha se kryetari, Shpend Ahmeti, është zotuar që në mbledhjen e ardhshme do të na japë një sqarim konkret rreth subvencionimit të mundshëm të linjave të autobusëve privatë, por kjo

shihet se sot nuk do të prezantohet. Nuk është hera e parë që këto mbledhje thirren në mënyrë të jashtëzakonshme, dhe kjo do të duhej të ishte një ndër mbledhjet e rregullta që e kemi në plan të punës së Kuvendit. Nëse nuk ka një sqarim rrith asaj çka kemi diskutuar herën e kaluar, unë nuk besoj që duhet me votuar një buxhet të tillë.

**Hafiz Krasniqi** tha se edhe pse ishte në procedurë edhe ndarja e mjeteve për projektin e kanalizimit për fshatin Makovc dhe Llukar, procedimi i këtij projekti i cili ende nuk ka filluar të realizohet. Ky lum i cili kalon përmes fshatrave Grashticë, Makovc, Llukar e deri në Prishtinë, vërtet mendohet këtu për një projekt i cili do të ishte vetëm projekt për mbylljen ose rregullimin e një kanalizimi, një projekt i cili kish me qenë shumë më i gjerë dhe shumë më konstruktiv, për arsy se është një pjesë atraktive e qytetit edhe lagjeve të qytetit, paralagjeve.

Lidhur me vërejtjet dhe sugjerimet e dhëna nga parafolësit, sqarime shtesë dha Valbona Makolli, drejtoreshë.

**Kryesuesi konstataoi se njëzëri, më 36 vota për u miratua Vendimi për bartjen e buxhetit të pashpenzuar nga viti 2020 në vitin 2021.**

#### Pika e dytë

**Propozimvendimi për autorizim të borxhit.**

Lidhur me këtë propozimvendim, Shpend Ahmeti, kryetar, tha se kjo pikë ka të bëjë me një vendim që e kemi marrë më herët, pra është votuar në Kuvend për eficiencën, diku 48 ndërtesa publike, që ka të bëjë me shkolla, me çerdhe dhe qendra të mjekësisë familjare (QMF) dhe duke u bazuar në ligj që ta kemi një linjë buxhetore, ku vendosen mjete financiare për realizimin e këtij projekti. Këtë vendim duhet sot ta miratojmë, pasi që këtë na e ka kërkuar Ministria e Financave.

**Kryesuesi konstataoi se më 29 vota për dhe 6 abstenime, u miratua Vendimi për autorizim të borxhit.**

#### Pika e tretë

**Propozimvendimi për dhënien në shfrytëzim të pronës së paluajtshme komunale, Bashkësisë Islame të Kosovës.**

Shpend Ahmeti, kryetar, tha se sa i përket këtij propozimvendimi, pra është fjala për xhamin e madhe që po ndërtohet në lokacion, të cilin ky Kuvend e ka votuar dhe pastaj Drejtoria e Urbanizmit ka kërkuar që të kërkohet qasje në rrugën "Ilaz Kodra", në mënyrë që për shkak të komunikacionit të ketë dy qasje te xhamia, që ajo rruga kalon ngjitur me pjesën - shkallët e kurrit të anën e majtë. Në atë rrugë janë dy shtëpi në pronën komunale, të cilat janë në shfrytëzim, por pengojnë që kjo rrugë të realizohet dhe tanë duhet shikuar mundësin se si të veprohet me ata dy pronar.

Faqe4nga5

**Agim Gashi** kërkoi të dijë se a do të duhej një herë Bashkësia Islame të lidhë marrëveshje me ato dy familje, në mënyrë që ato të mos na mbesin barrë neve, se po paragjykoj, në qoftë se ne e marrim këtë vendim dhe familjet i nxjerrim prej shtëpive, me shpresë që Bashkësia Islame e përbush premtimin e dhënë të panënskruar. Mendoj se do të ishte mirë që Bashkësia Islame me garantuar përmes një dokumenti që e bart barrën e financimit, pastaj ne ta marrim vendimin.

**Egzon Azemi** tha se do të ishte mirë që prej Bashkësisë Islame ta kemi një informatë ose një deklaratë rrëth kësaj çështjeje, se sa kanë kërkuar ato familje, për shkak se mundet me qenë një gabim i madh i Kuvendit komunal, nëse ne e japim lejen ose e votojmë këtë çështje, në të njëjtën kohë ato familje pastaj na padisin për shkak që paskan prona të dokumentuara.

**Fiknete Bejta** tha se njoftimi i dhënë nga kryetari lidhur me pronësinë e atyre dy familjeve, neve na jep siguri që nuk do të dëmtohen ato dy familje, dhe të procedojmë me ndërtimin e xhamisë, sepse besimtarët myslimanë meritojnë të ndërtohet një xhami të madhe, ta kenë një objekt ku mund ta zhvillojnë besimin e tyre.

Lidhur me çështjet e ngritura rrëth pronësisë së atyre dy familjeve, sqarime të nevojshme dha **Shpend Ahmeti**, kryetar.

Kryesuesi konstatoi se njëzëri, më 36 vota për u miratua Vendimi për dhënien në shfrytëzim të pronës së paluajtshme komunale, Bashkësisë Islame të Kosovës.

Mbledhja përfundoi në orën 12:00.

Procesmbajtësi  
Zijadin Gashi

Kryesuesi i Kuvendit  
Agim Kuleci



Faqe 5 nga 5